



Universiteti i Arteve
Nr. 899 Prot.
Më 08 / 05 /2026



Instituti Shqiptar i Sociologjisë
Nr. 110 Prot.
Më 08 / 05 /2026

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
UNIVERSITETIT TË ARTEVE TË TIRANËS
DHE
INSTITUTIT SHQIPTAR TË SOCIOLOGJISË**

Të vetëdijshëm për përfitimet e ndërsjellta të bashkëpunimit institucional dhe në vijim të përpjekjeve për të zgjeruar kontaktet midis dy institucioneve,

Universiteti i Arteve, Tiranë (në vijim UA), përfaqësuar nga **Prof. Dr. Erald Bakalli, Rektor** (me poshtë do të njihet si Pala 1), është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 234 datë 23.03.2011, i regjistruar me NIPT K51713024L, me adresë: Sheshi “Nënë Tereza”, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, dhe

Instituti Shqiptar i Sociologjisë – Albanian Institute of Sociology, në vijim AIS – anëtar i Rregullt e kolektiv i International Sociological Association, i përfaqësuar nga **Prof. Dr. Leke Sokoli, Drejtor** (me poshtë do të njihet si Pala 2) themeluar me 21 nëntor 2006, me NIPT L51712453Q, me adresë Rruga “Nikolla Tupe”, Pall. 4, Nr. 9 Tiranë.

Të dyja së bashku, referuar si Palët, bien dakord për të nënshkruar këtë marrëveshje bashkëpunimi, sipas klauzolave në vijim:

**Neni 1
Fushat dhe çështjet e bashkëpunimit**

1. Mbështetja e ndërsjelltë për realizimin e misioneve të secilit institucion, për të nxitur zhvillimin ndërdisiplinor të shkencave, për shkëmbimin e përvojave, botimeve akademike, teksteve etj. të realizuara nga anëtarë të stafit akademik dhe bashkëpunëtorët shkencorë të tyre.



Faqe 1 nga 3

2. Vënia në dispozicion të literaturës shkencore të çdonjërit nga institucionet për stafin akademik dhe bashkëpunëtorët shkencorë të institucionit partner;
3. Krijimi i një rrjeti të gjerë komunikimi, duke përfshirë anëtarët e stafit akademik dhe bashkëpunëtorët shkencorë të këtyre institucioneve, si dhe pasqyrimin e veprimtarive të përbashkëta në website-t, mediat e tyre apo në forma të tjera të mundshme;
4. Hartimi dhe realizimi i projekteve të përbashkëta kërkimore me fokus empirik dhe/apo testues, nga fusha e artit dhe ndikimit të tij në shoqërinë bashkëkohore;
5. Organizimi i përbashkët i konferencave shkencore, simpoziumeve, forumeve akademike, seminareve, leksioneve të hapura, trajnimeve, aktiviteteve të ndryshme, etj.
 - 5.1. Organizimi i një Forumi Akademik Vjetor, në kuadër të Ditës Botërore të Artit [International Day of Art] apo në një kohë të përshtatshme, të dakordësuar.
 - 5.2. Organizimin e përbashkët, si dhe me institucione të tjera partnere, të serisë së konferencave vjetore ndërkombëtare e ndërdisiplinore (të alternuara Shqipëri-Kosovë-Maqedoni e Veriut), duke filluar nga konferenca e 21-të vjetore me temë kuadër “Drejt një Shoqërie Inteligjente: sfida dhe mundësi” [Toward an Intelligent Society: Challenges & Opportunities] që do të mbahet në Universitetin Fehmi Agani të Gjakovës, në maj 2026.
 - 5.3. Bashkëorganizimi në Universitetin e Arteve dhe Universitetin e Sporteve të konferencës së vitit 2027 me temë kuadër “Arti dhe Sporti në shoqërinë e sotme dhe të ardhme” [Art & Sport in Present and Future Society]. Për detyrimet e ndërsjellëta si dhe për modalitetet e tjera të organizimit të kësaj konference vendoset bashkërisht, jo më vonë se një vit para zhvillimit të saj.

Neni 2

Mënyra e realizimit të veprimtarive

Palët bien dakord që realizimi i veprimtarive sipas nenit 1 të kësaj marrëveshjeje të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secila Palë. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme dhe ndjekja e zbatimit të Marrëveshjes, realizohet nga një komision i përbashkët, për përbërjen e të cilit vendosin nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje.

Neni 3


Aspektet financiare

Kjo marrëveshje nuk shkakton detyrime financiare.

Neni 4

Shkaqet madhore

Palët bien dakord që nëse nuk do jenë të afta të përmbushin detyrimet e tyre, për arsye të grevave ose mosmarrëveshjeve të punës, të çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme shkaktuar përtej mundësisë që kanë Palët për t'i kontrolluar, kjo nuk do të konsiderohet si prishje e marrëveshjes.




Neni 5
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit.
2. Ajo mund të zgjidhet para afatit të cituar në pikën 1, të këtij neni, me kërkesën e njëërës palë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën gjashtë muaj më parë.
3. Marrëveshja rinovohet automatikisht për një afat të pacaktuar nëse nuk ka kërkesë me shkrim për zgjidhjen e saj nga ndonjëra prej palëve nënshkruese.
4. Kjo marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, 1 (një) për secilën palë dhe pasi lexohet, firmoset nga titullarët e institucioneve respektive dhe merr fuqi zbatuese për institucionet përkatëse nga data e nënshkrimit të saj.

Rektor i Universitetit të Arteve


Prof. Dr. Erald BAKALLI

Drejtor i Institutit të Sociologjisë


Prof. Dr. Leke SOKOL

